

ANEKSI 22-14

Certifikata e origjinës për produktet që i nënshtrohen marrveshjeve/rregullimeve të veçanta jo- preferenciale të importit

Shënimet hyrëse:

1. Periudha e vlefshmërisë së certifikatës së origjinës do të jetë 12 muaj nga data e lëshimit prej autoriteteve lëshuese.
2. Çertifikatat e origjinës duhet të përbëhen vetëm nga një fletë të vetme e identifikuar me fjalën 'original' ngjitur me titullin e dokumentit. Nëse kopjet shtesë janë të nevojshme, ata duhet të mbajnë emërtimin 'copy' ngjitur me titullin e dokumentit. Autoritetet doganore do të pranojnë si të vlefshme vetëm origjinalin e certifikatës së origjinës.
3. Çertifikatat e origjinës duhet të kenë përmasat 210 × 297 mm; në gjatësi mund të lejohet një tolerancë deri në minus 5 mm ose plus 8 mm. Letra e përdorur duhet të jetë e letër e bardhë, të mos përmbajë brum mekanik dhe të peshojë jo më pak se 40 g/m². Pamja e certifikatës origjinale duhet të ketë një sfond jeshil model 'guillche' të printuar duke bërë që çdo fallsifikim me mjete mekanike ose kimike të jetë i dukshëm për syrin.
4. Çertifikatat e origjinës duhet të shtypen dhe të plotësohen në shtypshkrimin në gjuhën angleze. Shënimet nuk duhet të fshihen ose të mbishkruhen. Çdo ndryshim duhet të bëhet duke bërë me kryq shënimin e gabuar dhe, nëse është e nevojshme, duke shtuar të dhënat e sakta. Këto ndryshime duhet të firmosen nga personi që i bën ato dhe të miratohen nga autoriteti lëshues.

Të gjitha të dhënat shtesë të kërkuara për zbatimin e legjislacionit të R.Sh që drejton marrëveshjet e veçanta të importit duhet të futen në kutinë 5 të certifikatës së origjinës.

Hapësirat e pa përdorura në kutitë 5, 6 dhe 7 duhet të vijëzohen në një mënyrë të tillë që në një fazë të më vonshme të mos shtohet asnjë gjë.

5. Çdo certifikatë origjine duhet të mbajë një numër serial, i shtypur apo jo, me anë të të cilit mund të identifikohet, dhe mund të vulozet nga autoriteti lëshues dhe të nënshkruhet nga personi ose personat që janë të autorizuar për ta bërë këtë.
6. Certifikatat e origjinës të lëshuara në retrospektivë duhet të mbajnë në Kutinë 5 shënimin e më poshtëm në gjuhën angleze: "Issued *retrospectively*"